

REPUBLIKA E SHQIPERISE

GJYKATA E RRETHIT TIRANE

Nr.

6717

[Signature] 6117

V E N D I M

PER RIREGJISTRIMIN E PERSONIT JURIDIK

Ne Tirane, me 14.09.1993, une gjyqtarja e gjykates Tirane , Florina Tegu, mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga kerkuesi Ismail Çabej, per riregjistrimin e shoqerise " Rekor Albania" si shoqeri anonime dhe

KONSTATOVA se:

Kerkesa e paraqitur nga kerkuesi per riregjistrimin e shoqerise " Rekor Albania " si SH A me drejtor Ismail Çabej, per te ushtruar vep-rintarine ~~et~~ vet ne fushen e prodhimit , perpunimit dhe tregetitimit te lekurve , prodhimin dhe perpunimin e gomes dhe te produkteve plastike prodhimin dhe perpunimin e produkteve plastike, prej lekure dhe gome, pro dhimin e kepuceve te çdo lloji, trasportimin e produkteve te prodhuara ose te ~~ke~~ treteve , shfrytezim dyqanesh per tregetin e produkteve te prodhuara, perfaqesim dhe bashkepunim me shoqeri te tjera me objekt te njejte ose te perafert , eshte e drejte dhe dokumentet e paraqitura nga kerkuesi jane te plota.

PER KETO ARSYE

Ne baze te ligjit 7667 date 28.01.1993 dhe ligjit 7638 date 19.11.1993 " Per shoqerite tregetare"

VENDOSA

Riregjistrimin e shoqerise " Rekor Albania ", me qender ne Gjiroka ster, me drejtor Ismail Çabej, si person juridik per te ushtruar veprimta rine e vet ne fushen e prodhimit , perpunimit dhe tregetitimit te lekurve, prodhimin dhe perpunimin e gomes dhe produkteve plastike , prodhimin dhe perpunimin e produkteve plasike, prej lekure dhe gome, prodhimin e kepu- ceve te çdo lloji, trasportin e produkteve teprodhuara ose te treteve,

[Handwritten mark]

shfrytezim dyqanesh per tregetimin e produkteve te prodhuara , perfaqesim dhe bashkepunim me shoqeri te tjera me objekt te njejte ose te perafert.

Kunder ketij vendimi lejohet ankim ne shkalle te dyte.

Tirane me date 14.09.1993



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E TREGTISE DHE BASHKEPUNIMIT EKONOMIK ME JAShte
DREJTORIA E Nxitjes se Investimeve te huaja

A U T O R I Z I M

Nr. 39 Date 11.7.1992

Per

Krijimin e Ndermarrjes se Perbashket Shqiptaro-Greke
te emertuar "REKOR ALBANIA"

Me propozim te Ministrise se Industrise Burimeve Minerare dhe
Energjetike, Ministria e Tregtise dhe Bashkepunimit Ekonomik me
Jashte,

A u t o r i z o n

Lidhjen e kontrates per krijimin e Ndermarrjes se Perbashket Shqiptaro-
Greke te emertuar "REKOR ALBANIA" ndermjet Fabrikes se Lekure-Kepuces ne
Gjirokaster dhe pales greke te perbere nga shoqeria greke "REKOR S.A" dhe per-
soni fizik zoti Spiros Papafotiu nenshtetas grek, te cilet jane me seli ne
Athine, Greqi, me kushtet kryesore si me poshte :

1. Objekti i veprimtarise se Ndermarrjes se Perbashket "REKOR ALBANIA"
do te jete ai i percaktuar ne nenin 3 te kontrates bashkelidhur .
2. Ndermarrja e perbashket "REKOR ALBANIA" do te konsiderohet person
juridik shqiptar dhe do ti nenshtrohet legjislacionit shqiptar.
3. Kapitali baze i Ndermarrjes se Perbashket eshte 14 milione e 941 mije
dollare USA me kontributet e seciles pale ne natyre dhe/ose ne para, si me
poshte:

Pala shqiptare	2 milione e 267 mije dollare USA
Pala e huaj	12 milione e 674 mije dollare USA

Kontributet e seciles pale do te derdhen brenda nje viti nga data e
leshimit te ketij autorizimi.

4. Fitimi qe do te rezultoje ne fund te vitit fiskal do te ndahet 15.2%
per palen shqiptare dhe 84.8% per palen greke.
5. Afati i autorizimit per veprimtarine e Ndermarrjes se Perbashket do
te jete 10 vjet me te drejte perteritje me marreveshje te paleve.
6. Rregjistrimi ne Ministrine e Financave dhe Ekonomise i Ndermarrjes se
Perbashket "REKOR ALBANIA" do te behet brenda 30 diteve nga data eleshimit te
ketij autorizimi. Me regjistrimin caktohen edhe tatimet dhe taksat qe do te
paguhen sipas legjislacionit ne fuqi.
7. Autorizimi eshte i vlefshem vetem me kontraten dhe statutin bash-
kelidhur.

Nr. 361/ Prot.
Tirane, me 11.7.1992



MINISTRI
Artan Hoxha

Artan Hoxha

1

K O N T R A T E

SHOQËRIË ANONIME "REKOR ALBANIA SH.A

Sot, me 10.9.1993, ne Gjirokaster, midis :

a) Fabrikes se lekure - kepuceve, person juridik shqiptar me seli ne gjirokaster dhe

b) shoqerise greke REKOR ABEE, me seli ne Athine Greqi, shoqeri prodhimi kepucesh dhe produktesh gome, te perfaqesuar legalisht nga z. Spiros Papafotiu, i cili ne rastin konkret vepron edhe per vete, u ra dakord per sa me poshte vijojne:

palet e siperpermendura, me statut dhe kontrate te rregullt, kane krijuar ndermarrje e perbashket shqiptaro - greke me emrin REKOR ALBANIA, e cila eshte miratuar nga Ministria e Tregetise dhe Bashkepunimit Ekobnomik me Jashte te Republikes se Shqiperise, me shkresen nr.39 date 11.7.1992.

Ndermarrja ne fjale u regjistrua ne regjistrin e Ministrise se Ekonomise dhe Financave, me shkresen nr. 39. Datë 11.7.1992

Me qellim qe dokumentet e mesiperme te harmonizohen me dispozitat e ligjeve 7638/19.11.1992 "Per shoqerite tregetare" dhe 7667/28.1.1993 "Per regjistrin tregetar dhe formalitet qe duhen respektuar nga shoqerite tregetare" dhe ne vecanti me kerkesat e nenit 64 te ligjit 7667/28.1.1993 palet e kontraktuara ripunojne dokumentacionin baze te shoqerise (statut dhe kontrate) si me poshte:

Para se gjithash theksohet se te drejtat dhe detyrimet e te dy pal-eve, sic jane miratuar nga organet kompetente , respektohen plotesisht, ruhen te pandryshueshme dhe harmonizohen thjesht me ligjin "Per shoqerite tregetare".

NENI 1

Emri i shoqerise do te jete REKOR ALBANIA Sh.A. dhe do te jete person juridik shqiptar me qender ne Gjirokaster. Afati i saj percaktohet ne 15 vjet, afat ky qe mund te zgjatet me vendim te Ansamblese se Pergjithshme. Me formen e saj te re shoqeria do te funksionoje pas riregjistrimit te saj ne Regjistrin Tregetar te Republikes se Shqiperise. Deri atehere do te funksionoje ne formen e saj ekzistuese.



10

NENI 2

Qellim i shoqerise eshte:

1. Prodhimi, perpunimi dhe tregetimi i lekurave
2. Prodhimi dhe perpunimi i gomes dhe produkteve plastike
3. Prodhimi dhe perpunimi i produkteve plastike, prej lekure dhe gome.
4. Prodhimi i kepuceve te cdo lloji.
5. Transporti i produkteve te prodhuara ose te te treteve.
6. Shfrytëzim dyqanesh per tregetimin e produkteve te prodhuara.
7. Perfaqesimi dhe bashkepunimi me shoqeri te tjera me objekt te njejte ose te perafert.

KAPITALI THEMELTAR - AKSIONET

NENI 3

Me 22.5.1992 u ra dakord qe kapitali themeltar i shoqerise do te jete 14. 941.000 \$ USA. Kapitali i siperpermendur eshte miratuar dhe nga Ministria e Tregetise dhe e Bashkepunimit Ekonomik me Jashte, me shkresen nr. 39/11.7.1992.

Ne baze te dispozitave te ligjit shqiptar ky kapital duhet te shprehet ne leke. Ne baze te kursit te dollarit ndaj lekut te dates 22.5.1992 kapitali i mesiperm i korrespondon shumes prej *52634200*
15389230 leke.

Kapitali i mesiperm ndahet ne *15389230* aksione, secila me vlere 100 leke. Secili ortak do te marre aq aksione sa i korrespondojne kapitalit te vene. Aksionet do te jene anonime dhe do te kene te shkruar siper tyre kapitalin, emrin e shoqerise, si dhe vendimin per krijimin e saj. Do te jene te numeruara, te nenshkruara nga kryetari i Keshillit Mbikqyres dhe nga drejtori i shoqerise dhe do te jene te vulosura me vulen e shoqerise.

Per cdo shtese te kapitalit themeltar do te vihen ne qarkullim edhe aksionet perkatese. Aksionet e mesiperme do te vihen ne qarkullim me vendim te Keshillit Mbikqyres edhe ne tituj te shumefishte.

Pala shqiptaqre merr pjese me 15.2% te kapitalit kurse pala greke me 84.8% te kapitalit, sic eshte vendosur me kontraten e dates 22.5.1992.

BEKOR - ALBANIA S.A.

NDERRMARJA PERBASHKET

LEKURE - REPUBLIKA

SHKALLA

TEL: 00355 121 3 23 0009

FAX: 3101

0.402

J *11*

J

Deri me sot pala shqiptare ka derdhur kontribut ne natyre (godina, lende te para, makineri dhe siperfaqen e tokes) 2. 267. 000 \$ USA, shume e barabarte me 233.501.000 leke ne baze te kursit te dollarit ndaj lekut me date 22.5.1992.

Nga ana e pales greke jane derdhur 500. 000 \$ USA dhe 48. 007. 000 drahami ne mjete monetare, ne makineri 656. 627 000 drahami, ne lende te para etj 312. 954. 401 drahami dhe ne Know how etj 1. 160. 200 \$ USA. Shuma e mesiperme e shprehur ne leke ne baze te kursit te dollarit te dates 22.5.1992 eshte 625540360 leke. Pjesa e kapitalit te pales greke qe ka mbetur pa u derdhur akoma do te derdhet brenda dates 31.12.1993, date ne te cilen do te behet kontrolli per kapitalet e derdhura nga te dy palet.

PALËT E KONTRAKTUARA

PËR FABRIKËN LËKURË - KËPUÇA
GJIROKASTER

ISMAIL ÇABEJ

REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E DREJTËSISË
NOTERIA

PËR REKOR ABEE
ATËINË

SPIRO PAPAFO TIU

Nr. _____

V E R T E T I M

Sot, më 18.09.1993 , në GJIROKASTER , u paraqitën para meje z. SPIRO PAPAFO TIU dhe z. ISMAIL ÇABEJ , për indetitetin e të cilve u sigurova nga letër njoftimet , madhorë dhe me zotësi të plotë për të vepruar, të cilët nënshkruan me vullnetin e tyre të lirë kontratën e shoqërisë anonime "REKOR ALBANIA" SH.A.

Duke qënë se janë në përputhje me ligjin unë e legalizova atë.



NOTERI
KUJTIM IDRIZI

[Handwritten signature]

12

STATUT I SHOQERISE ANONIME REKOR ALBANIA

Sot, me 10.9.1993, ne Gjirokaster, midis :

a) Fabrikes se lekure - kepuceve, person juridik shqiptar me seli ne gjirokaster dhe

b) shoqerise greke REKOR ABEE, me seli ne Athine Greqi, shoqeri prodhimi kepucesh dhe produktesh gome, te perfaqesuar legalisht nga z. Spiros Papafotiu, i cili ne rastin konkret vepron edhe per vete, u ra dakord per sa me poshte vijojne:

palet e siperpermendura, me statut dhe kontrate te rregullt, kane krijuar ndermarrje e perbashket shqiptaro - greke me emrin REKOR ALBANIA, e cila eshte miratuar nga Ministria e Tregetise dhe Bashkepunimit Ekobnomik me Jashte te Republikes se Shqiperise, me shkresen nr. 39 date 11.7.1992.

Ndermarrja ne fjale u regjistrua ne regjistrin e Ministrise se Ekonomise dhe Financave, me shkresen nr.

Me qellim qe dokumentet e mesiperme te harmonizohen me dispozitat e ligjeve 7638/19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe 7667/28.1.1993 "Per regjistrin tregetar dhe formalitet qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare" dhe ne vecanti me kerkesat e nenit 64 te ligjit 7667/28.1.1993 palet e kontraktuara ripunojne dokumentacionin baze te shoqerise (statut dhe kontrate) si me poshte:

Para se gjithash theksohet se te drejtat dhe detyrimet e te dy pal-eve, sic jane miratuar nga organet kompetente, respektohen plotesisht, ruhen te pandryshueshme dhe harmonizohen thjesht me ligjin "Per shoqerite tregtare".

NENI 1

Emri i shoqerise do te jete REKOR ALBANIA Sh.A. dhe do te jete person juridik shqiptar me qender ne Gjirokaster. Afati i saj percaktohet ne 15 vjet, afat ky qe mund te zgjatet me vendim te Ansamblese se Pergjithshme. Me formen e saj te re shoqeria do te funksionoje pas riregjistrimit te saj ne Regjistrin Tregetar te Republikes se Shqiperise. Deri atehere do te funksionoje ne formen e saj ekzistuese.

BEROF SHQIPARIA
NDERRMARRJA PER
LEKURE - KEPUCE
GJIROKASTER - ALBANIA
TEL: 00355-724 31313049
FAX: 3731

NENI 2

Gellim i shoqerise eshte:

1. Prodhimi, perpunimi dhe tregetimi i lekurave
2. Prodhimi dhe perpunimi i gomes dhe produkteve plastike
3. Prodhimi dhe perpunimi i produkteve plastike, prej lekure dhe gome.
4. Prodhimi i kepuceve te cdo lloji.
5. Transporti i produkteve te prodhuara ose te te treteve.
6. Shfrytezim dyqanesh per tregetimin e produkteve te prodhuara.
7. Perfaqesimi dhe bashkepunimi me shoqeri te tjera me objekt te njejte ose te perafert.

KAPITALI THEMELTAR - AKSIONET

NENI 3

Me 22.5.1992 u ra dakord qe kapitali themeltar i shoqerise do te jete 14. 941.000 \$ USA. Kapitali i siperpermendur eshte miratuar dhe nga Ministria e Tregetise dhe e Bashkepunimit Ekonomik me Jashte, me shkresen nr. 39/11.7.1992.

Ne baze te dispozitave te ligjit shqiptar ky kapital duhet te shprehet ne leke. Ne baze te kursit te dollarit ndaj lekut te dates 22.5.1992 kapitali i mesiperm i korrespondon shumes prej 1538923000 leke.

Kapitali i mesiperm ndahet ne 15.389.230 aksione, secila me vlere 100 leke. Secili ortak do te marre aq aksione sa i korrespondojne kapitalit te vene. Aksionet do te jene anonime dhe do te kene te shkruar siper tyre kapitalin, emrin e shoqerise, si dhe vendimin per krijimin e saj. Do te jene te numeruara, te nenshkruara nga kryetari i Keshillit Mbikqyres dhe nga drejtori i shoqerise dhe do te jene te vulosura me vulen e shoqerise.

Per cdo shtese te kapitalit themeltar do te vihen ne qarkullim edhe aksionet perkatese. Aksionet e mesiperme do te vihen ne qarkullim me vendim te Keshillit Mbikqyres edhe ne tituj te shumefishte.

Pala shqiptaqre merr pjese me 15.2% te kapitalit kurse pala greke me 84.8% te kapitalit, sic eshte vendosur me kontraten e dates 22.5.1992.



Deri me sot pala shqiptare ka derdhur kontribut ne natyre (godina, lende te para, makineri dhe siperfaqen e tokes) 2. 267. 000 \$ USA, shume e barabarte me ~~4-055400~~ 233,501,000 leke ne baze te kursit te dollarit ndaj lekut me date 22.5.1992.

Nga ana e pales greke jane derdhur 500. 000 \$ USA dhe 48. 007. 000 dhrahmi ne mjete monetare, ne makineri 656. 627 000 dhrahmi, ne lende te para etj 312. 954. 401 dhrahmi dhe ne Know how etj 1. 160. 200 \$ USA. Shuma e mesiperme e shprehur ne leke ne baze te kursit te dollarit te dates 22.5.1992 eshte 6 25540360 leke. Pjesa e kapitalit te pales greke qe ka mbetur pa u derdhur akoma do te derdhet brenda dates 31.12.1993, date ne te cilen do te behet kontrolli per kapitalet e derdhura nga te dy palet.

NENI 4

DREJTIMI I SH.A.

Organet drejtuese te Sh.A.

Drejtoria e shoqerise perbehet nga drejtori dhe dy nendrejtoret, te cilet emerohen nga Keshilli Mbikqyres. Drejtori ushtron vete kompetencat qe do t'i jipen nga organi i mesiperme i shoqerrise. Ndryshe nga drejtori, dy nendrejtoret ushtrojne kolegjialisht kompetencat me te cilat i ka ngarkuar organi kompetent.

Drejtoria raporton per veprimtarine e saj tek Keshilli Mbikqyres dhe mban pergjegjesi per cdo veprim qe nuk perputhet me detyrat dhe kompetencat e saj.

Anetaret e Drejtorise mund te marrin pjese ne te gjitha mbledhjet e Ansamblese se Pergjithshme, pa te drejte vote. Te drejte vote kane vetem ne rast se jane edhe aksionere.

Afati i mandatit te tyre eshte dy (dy) vjet. Mund te shkarkohen nga detyra me vendim te Keshillit Mbikqyres, i cili eshte kompetent te gjykoje nese jane te afte per detyren qe u eshte ngarkuar. Me vendimin e mesiperme Keshilli Mbikqyres emerom edhe zevendesin e tij, afati i mandatit te te cilit eshte i barabarte me kohen e mbetur nga mandati i paraardhesit te tij.

REKOR - ALBANIA S.A.

NDERRMARJA PERSASHKET

LEKIDE - REPUBLICA

6 NR. ANISTER - ALBANIA

TEL. 00361 461 1 43869

FAX. 3131



NENI 5

KESHILLI MBIKQYRES

Keshilli Mbikqyres ushtron kontrolli te vazhdueshem mbi Drejtorine e shoqerise. Drejtoria i raporton Keshillit Mbikqyres te pakten nje here ne tre muaj.

Brenda tre muajve nga data e mbarimit te vitit financiar, Drejtoria i paraqet Keshillit Mbikqyres bilancin dhe cdo dokument tjeter qe ka lidhje me gjendjen ekonomike te shoqerise, me qellim qe te shqyrtohen dhe te kontrollohen keto nga Keshilli Mbikqyres.

Keshilli Mbikqyres i parashton Ansamblese se Pergjithshme ne mbledhjen e saj vjetore verejtjet e tij ne lidhje me raportin e Drejtorise, bilancin dhe dokumentet e tjera.

NENI 6

PERBERJA E KESHILLIT MBIKQYRES

Keshilli Mbikqyres perbehet nga gjashte (6) anetare. 2/3 e anetareve te tij, dmth. kater (4) anetare, zgjidhen nga Ansambleja e Pergjithshme ne baze te nenit 93 te ligjit 7638/1992 dhe jane personat e meposhtem:

1. Konstantinos T. Argjiriu, 1939, Athina Greqia
2. Anna Papafotiu, 1941, Athina Greqia
3. Marios Hasiotis, 1969, Athina Greqia dhe
4. Maria Papafotiu, 1959, Athina Greqia

Afati i mandatit te anetareve te mesiperm te Keshillit Mbikqyres caktohet ne 3 vjet.

1/3 e anetareve te Keshillit Mbikqyres, dmth. dy (2) anetare, do te zgjidhen nga te punesuarit ne shoqeri, ne baze te dispozitave te neneve 109 - 110 te ligjit 7638/1992, brenda nje muaji nga data e riregjistrimit te shoqerise ne Regjistrin Tregetar.

Keshilli Mbikqyres zgjedh nga gjiri i vet Kryetarin dhe Nenkryetarin e tij. Ne rast se eshte e pamundur zgjedhja e tyre per arsye te votave te barabarta, kompetente per te zgjedhur Kryetarin dhe Nenkryetarin eshte Ansambleja e Pergjithshme e ortakeve.

Keshilli Mbikqyres mblidhet kur jane prezente te pakten gjysma e anetareve te tij. Vendimet merren me shumice te thjeshte votash te

BEKOR - ALBANIA S.A.
NDERMARTIA PERBASHKET

Hocina
TULLA
PLAKA
SHK. 007

J S

pjesemarrësve. Ne rast se ne mbledhje marrin pjese vetem tre (3) ane-
tare, atehere mund te marrin vendim vetem nqs. midis tyre eshte edhe
Kryetari i Keshillit Mbikqyres dhe kane mendim unanim

NENI 7

ANSAMBLEJA E PERGJITHSHME E ORTAKEVE MBLEDHJA E RREGULLT

Ansambleje e Pergjithshme e ortakeve (e rregullt ose e jashteza-
konshme) thirret nga Keshilli Mbikqyres i shoqerise.

Ansambleja e rregullt e Pergjithshme e ortakeve mblidhet te pakten
nje here ne vit, jo me vone se gjashte muaj nga data e perfundim it te
vitet financiar.

Ansambleja e rregullt e Pergjithshme shqyrton rezultatet ekonomike
te vitit te kaluar financiar, vendos per problemet ekonomike te shoqe-
rise, zgjedh anetaret e Keshillit Mbikqyres, percakton afatin e manda-
titb te tyre, ploteson vendet bosh ne Keshillin Mbikqyres, percakton
shperblimin e anetareve te tij, kontrollon marreveshjet ekonomike tesh-
qerise me te trete, sic parashikohet ne nenin 123 te ligjit 7638/1992
dhe mund t'i shpalle ato te pavlefshme sic parashikohet ne nenin 125 te
ketij ligji.

Ansambleja e rregullt e pergjithshme mblidhet nqs. ne te marrin
pjese aksioneret ose perfaqesuesit e ligjshem te tyre qe zoterojne te
pakten 25% te aksioneve me te drejte vote. Ne rast se ne mbledhjen e
pare nuk realizohet kjo pjesemarrje, ne mbledhjen e dyte merren vendime
te vlefshme kur aksioneret e pranishem zoterojne te pakten 20% te
aksioneve me te drejte vote, por jo me pak se kaq.

Vendimet e Ansamblese se rregullt te pergjithshme merren me shumice
te thjeshte te votave qe zoterojne aksioneret e pranishem ose te per-
faqesuar.

NENI 8

MBLEDHJA E JASHTEZAKONSHME E ANSAMBLESE SE PERGJITHSHME

Ansambleja e Pergjithshme ne mbledhjen e saj te jashtezakonshme
vendos per ndryshime qe mund t'i behen statutit te shoqerise.

Ansambleja e Jashtezakonshme merr vendime te vlefshme vetem ne rast

REKOR - ALBANIA S.A.
NDEF

26

se aksioneret e pranishem ose te perfaqesuar zoterojne ne mbledhjen e pare te pakten gjysmen e aksioneve dhe ne te dyten 1/4 e aksioneve me te drejte vote.

Vendimet e Ansamblese se Jashtezakonshme jane te ligjme kur merren me shumice 3/4 e v otave te aksionereve pjesemarres me te drejte vote ose perfaqesuesve te ligjshem te tyre.

NENI 9

Njoftimi per thirrjen e Ansamblese se Pergjithshme duhet te per- mende daten, oren, vendin e mbledhjes si dhe llojin e Ansamblese (e rregullt ose e jashtezakonshme) dhe rendin e saj te dites. Njoftimi do t'u dergohet ortakeve me leter rekomande, e cila do te postohet te pakten 20 dite para mbledhjes.

Aksioneret e shoqerise jane te detyruar qe te pakten pese (5) dite para mbledhjes te kene depozituar aksionet e tyre ne arken e shoqerise ose ne nje banke te njohur te qendres ku do te funksionoje shoqeria, e cila do t'i ppajise me vertetimin perkates. Ne rast te kundert nuk kane te drejte te marrin pjese ne mbledhjen e Ansamblese se Pergjithshme, me perjashtim te rastit kur kjo gje lejohet nga Kryetari i saj.

Gjithashtu, aksioneret jane te detyruar qe brenda muajit te pare te cdo viti kalendarik te t'i njoftojne Keshillit Mbikqyres adresen e tyre, nete cilen do t'u dergohet njoftimi i mesiperem. Ne rast se nuk njoftojne adresen e tyre ose cdo ndryshim te saj, njoftimi do te dergo- het ne adresen e vjeter dhe do te konsiderohet se aksioneri eshte njof- tuar ne kohe per mbledhjen e Ansamblese edhe nga njoftimi iafishuar ne zyrat e shoqerise 20 dite para mbledhjes se Ansamblase.

NENI 10

KONTROLLI I SHOQERISE

Kontrolli i shoqerise ushtrohet nga nje(1) ekspert kontabel.

Ne rast se pakica, sipas nenit 173 te ligjit 7638/1992, nuk eshte dakord me emerimin e ekspertit konkret kontabel per aresye qe kane te bejne vetem me personin e tij, duhet qe t'i paraqese me shkrim Ansamblese se Pergjithshme aresyet e mesiperme. Ne vazhdim Ansambleja e Pergjithshme propozon ekspert tjeter kontabel. Ne rast se pakica e

REKOR - ALBANIA S.A.

NDERRA



mesiperme me te njejten menyre kundërshton edhe kandidaturen e dyte, atehere ka te drejte t'i drejtohet gjykates.

Detyrat e ekspertit kontabel percaktohen ne nenin 178 te ligjit 7638/1992. Ne vecanti ka per detyre te garantoje se bilancet vjetore jane hartuar drejt dhe me sinqeritet, te jape nje pasqyre te sakte te rezultateve te vitit te kaluar ekonomik dhe veprimtarise ekonomike, si dhe gjendjes ekonomike te shoqerise ne fund te ketij viti.

NENI 11

PRISHJA E SHOQERISE

Shoqeria priset me vendim te Ansamblese se Pergjithshme.

Shoqeria priset automatikisht me mbarimin e afatit te saj- me perjashtim te rastit kur Ansambleja e Pergjithshme vendos shtyrjen e afatit te saj- ose ne rast humbjeje aktivi, sipas nenit 185 & 190 te ligjit 7638/1992.

NENI 12

KAPITALI REZERV

Nga fitimet e cdo viti financiar, duke zbritur nqs. kjo gjykohet e domosdoshme humbjet e vitit te kaluar financiar, do te hiqet menjane nje perqindfje jo me vogel se $1/20$ e fitimeve, kapital ky qe perben kapitalin rezerv te shoqerise.

NENI 13

NDARJA E FITIMIT

Duke respektuar dispozitat e nenit 214 te ligjit 7638/1992, Ansambleja e Pergjithshme vendos per ndarjen e fitimit te shoqerise.

NENI 14

PERCAKTIMI I DIVIDENTEVE

Dividentet e percaktuar jo sipas dispozitave te nenit 215 te ligjit 7638/1992 konsiderohen fiktive dhe aksioneret jane te detyruar t'i rikthejne shoqerise diferencen nga dividentet reale.

REKOR - ALBANIA S.A.
1992

NENI 15

LIKUJDIMI I SHOQERISE

Kur priset shoqeria, kryhet likujdimi i saj ne baze te dispozitave te ligjit "Mbi shoqerite tregtare" te Republikes se Shqiperise".

NENI 16

ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE MIDIS ORTAKEVE

Te dy palet do te mundohen me te gjitha menyrat te zgjidhin me mirekuptim mosmarreveshjet e mundshme. Ne rast te kundert, zgjidhja e tyre do te behet me arbitrazh. Per kete aresye cdo pale cakton arbitrin e vet. Kryearbiter caktohet Kryetari i Dhomes se Tregetise se Parisit dhe respektohet e Drejta Franceze. Cdo mosmarreveshje tjeter do te zgjidhet ne baze te dispozitave te nenit 293 te ligjit 7638/1992.

NENI 17

Per sa u perket ceshtjeve te tjera, respektohen dispozitat e ligjit "Per shoqerite tregtare" te Republikes se Shqiperise.

Ky statut u hartua ne tri (3) kopje ne gjuhen shqipe dhe ne gjuhen greke. nga nje kopje morren ortaket dhe e treta iu paraqit gjykates.

PALET E KONTRAKTUARA

gsmail cabaj

[Signature]
BEKOR ZACBANIA S.A.
MERIMARJA PERBASHKET
LEKURE - KUPUCA
GJIROKASTER - ALBANIA
TEL: 00355-726 31211859
FAX: 3731

[Signature]